

V E N D I M
Nr.222, datë 15.5.1995

**PËR SISTEMIMIN E INFORMACIONIT DHE TË DOKUMENTACIONIT SHKENCOR E
TEKNIK**

Me propozimin e Komitetit të Shkencës dhe të Teknologjisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Sistemi i informacionit dhe i dokumentacionit shkencor e teknik përbëhet nga Qendra e Informacionit dhe e Dokumentacionit Shkencor e Teknik në varësi të KSHT dhe njësitë e informacionit e të dokumentacionit shkencor e teknik të specializuara ose në përbërje të sektorëve, qendrave etj., që përpunojnë informacion të përgjithshëm të institucioneve shkencore, të bibliotekave qendrore, të universiteteve e të shkollave të larta, të Akademisë së Shkencave, të ministrive e të institucioneve qendrore, të pushtetit lokal etj.

2. Sistemi i informacionit dhe i dokumentacionit shkencor e teknik ka këto detyra kryesore:

- Evidenton burimet, prodhuesit dhe përdoruesit e informacionit e të dokumentacionit shkencor e teknik.

- Siguron grumbullimin dhe sistemimin e informacionit dhe të dokumentacionit shkencor e teknik të prodhuar në vend e të ardhur nga jashtë, si dhe përhapjen dhe këmbimin e tij brenda vendit dhe jashtë tij.

3. Krijohet Këshilli për Informacionin dhe Dokumentacionin Shkencor e Teknik pranë KSHT prej 15 vetash me përfaqësues të sistemit kërkimor të ministrive, Akademisë së Shkencave, universiteteve e shkollave të larta, bibliotekave qendrore dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave. Përbërja dhe rregullorja e tij miratohet nga Kryetari i Komitetit të Shkencës dhe të Teknologjisë. Organ ekzekutiv i Këshillit është Qendra e Informacionit dhe e Dokumentacionit Shkencor e Teknik.

4. Këshilli për Informacionin dhe Dokumentacionin Shkencor e Teknik ka këto detyra kryesore:

- Bën planifikimin dhe strategjinë e zhvillimit të sistemit të informacionit dhe të dokumentacionit shkencor e teknik në vend.

- Bashkërendon veprimtaritë e pjesëve të ndryshme të sistemit të informacionit dhe të dokumentacionit shkencor e teknik.

- Drejton dhe vendos rregullat për funksionimin e shërbimit të informacionit në rrjet dhe zhvillimin e tij, që po ngrihet i mbështetur nga projekti “Për krijimin e shërbimit të informacionit në rrjet” në kuadrin e programit kombëtar PHARE 94 për veprimtaritë për kërkim e zhvillim.

- Krijon dhe zhvillon lidhjet ndërkombëtare në fushën e informacionit dhe të dokumentacionit shkencor e teknik.

5. Qendra e Informacionit dhe e Dokumentacionit Shkencor e Teknik ka këto detyra kryesore:

- Grumbullon dhe sistemon gjithë informacionin dhe dokumentacionin shkencor e teknik të publikuar në vend.

- Vendosi kriteret dhe standardet për përpunimin e informacionit dhe të dokumentacionit shkencor e teknik të vendit dhe të ardhur nga jashtë, të detyrueshme për të të gjitha njësit e informacionit dhe të dokumentacionit shkencor e teknik.

- Krijon baza dokumentare për informacionin shkencor e teknik të prodhuar në vend për të gjitha fushat e shkencës e teknologjisë.

- Përpunon dhe përhap prodhime dokumentare për informacionin për fusha të ndryshme të shkencës e të teknologjisë.

- Grumbullon, përpunon dhe përhap informacione për politikën shkencore e të zhvillimit teknologjik.

- Kryen shërbime këshillimore në fushën e informacionit dhe të dokumentacionit shkencor e teknik.

- Siguron shfrytëzimin në rrjet të bazave të saj dokumentare për komunitetin shkencor të vendit.

- Kryen funksionet e organit ekzekutiv të Këshillit të Informacionit dhe të Dokumentacionit

Shkencor e Teknik për shërbimin e informacionit në rrjet.

- Bën kualifikimin e specialistëve të informacionit dhe të dokumentacionit shkencor e teknik.

- Mban lidhje dhe përfaqëson vendin në organizmat ndërkombëtarë të informacionit dhe të dokumentacionit shkencor e teknik.

6. Njësitë e informacionit dhe të dokumentacionit shkencor e teknik të specializuara dhe sektorët, qendrat etj., që përpunojnë informacion të përgjithshëm sipas pikës 1, kanë për detyrë:

- T'i sigurojnë Qendrës së Informacionit dhe të Dokumentacionit Shkencor e Teknik gjithë informacionin dhe dokumentet dytësore për veprimtarinë shkencore e teknologjike, të publikuar ose jo, për institucionin pranë të cilit funksionojnë, brenda një muaji nga data e publikimit ose e përfundimit të dokumentave përkatëse.

- Të kontrollojnë përshkrimin bibliografik dhe analitik të publikimeve shkencore e teknologjike para botimit të tyre.

7. Analiza dhe indeksimi i dokumenteve parësore të publikuara nga institucionet përkatëse për përfitim të dokumenteve dytësore bëhet sipas kriterëve të vendosura në bashkëpunim me Qendrën e Informacionit dhe të Dokumentacionit Shkencor e Teknik.

8. Të gjitha institucionet që botojnë dokumentacionin shkencor e teknologjik (monografi, revista, buletine, përmbledhje studimesh, libra tekniko-shkencorë etj), të dërgojnë një kopje pa shpërblim në Qendrën e Informacionit dhe të Dokumentacionit Shkencor e Teknik.

9. Detyrat e tjera të njësive të informacionit dhe të dokumentacionit shkencor e teknik të specializuara dhe sektorët, qendrat etj., që përpunojnë informacion të përgjithshëm sipas pikës 1, caktohen me vendimet përkatëse të institucioneve për krijimin e tyre.

10. Ngarkohet KSHT të ndjekë hartimin dhe zbatimin e projektit “Për krijimin e shërbimit të informacionit në rrjet” në kuadrin e programit kombëtar PHARE 1994 për veprimtarinë për kërkim e zhvillim.

11. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.283, datë 30.6.1981 “Për organizimin e sistemit të informacionit dhe të dokumentacionit shkencor e teknik”, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi